



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I EMËRIMEVE NË DREJTËSI

VENDIM

Nr. 100, datë 30.07.2019

PËR LEJIMIN E KANDIDIMIT TË Z. ARTUR METANI NË VENDIN VAKANT
PËR INSPEKTOR I LARTË I DREJTËSISË, SHPALLUR NGA KËSHILLI I
EMËRIMEVE NË DREJTËSI NË DATËN 01.03.2019

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, i përbërë nga:

Ardian Dvorani	- Kryetar
Vitore Tusha	- Zëvendëskryetare
Arta Marku	- Anëtare
Margarita Buhali	- Anëtare/Relatore
Fatjona Memçaj	- Anëtare
Fatri Islamaj	- Anëtar
Eriol Roshi	- Anëtar

Asistuar nga sekretare **Dorina Dulaj**,

Me praninë e **Avokates së Popullit, znj. Erinda Ballanca**, në cilësinë vëzhguesit të përhershëm të mbledhjeve dhe veprimtarisë së Këshillit të Emërimeve në Drejtësi,

Me praninë e përfaqësuesve të autorizuar të subjekteve të ftuara sipas ligjit për pjesëmarrje, në cilësinë e vëzhguesve, në mbledhjen e Këshillit:

- **z. Bledar Dervishaj**, përfaqësuesi i autorizuar i Presidentit të Republikës,

në mbledhjen e datës 30.07.2019, mori në shqyrtim çështjen që i përket:

**KANDIDAT PËR INSPEKTOR
I LARTË I DREJTËSISË**

Z. Artur Metani

OBJEKTI:

Urdhërimi i lejimit të kandidimit të z. Artur Metani, në vendin vakant për Inspektor i Lartë i Drejtësisë, të shpallur nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi në datën 01.03.2019.

KËSHILLI I EMËRIMEVE NË DREJTËSI

Pasi dëgjoi raportimin e anëtares së Këshillit, **znj. Margarita Buhali**, mendimin e paraqitur nga Avokati i Popullit, znj. Erinda Ballanca, në cilësinë e vëzhgueses së përhershme në mbledhjen dhe veprimtarinë e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, lidhur me mënyrën e procedimit të ndjekur për verifikimin e kandidatit dhe si bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Në zbatim të nenit 147/d të Kushtetutës dhe të nenit 199 dhe 229 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, në datën 01.03.2019, ka shpallur hapjen e procedurës së aplikimeve për vendin vakant për Inspektor i Lartë i Drejtësisë.

2. Në përfundim të procedurës së aplikimeve për shprehjen e interesit për kandidim, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi ka filluar shqyrtimin e aplikimeve të kandidatëve të shoqëruara me dokumentet e paraqitura prej tyre për përmbushjen e kushteve dhe kritereve ligjore të përcaktuara në nenin 199 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”.

3. Ndërmjet kandidatëve që kanë shprehur interesin për plotësimin e këtij vendi vakant për Inspektor i Lartë i Drejtësisë, është edhe z. Artur Metani.

4. Në zbatim të nenit 147/d dhe 149/d të Kushtetutës dhe të nenit 199, 229 dhe 235 e vijues të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, si edhe të pikës 98 të aktit nënligjor normativ, Vendimi i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi me nr. 4 datë 11.03.2019 “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, në mbledhjen e zhvilluar në datën 05.04.2019, vendosi fillimin e procedurave të verifikimit, vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes të kandidatëve që kanë shprehur interesin për vendin vakant për Inspektor i Lartë i Drejtësisë.

5. Në zbatim të nenit 228 të Ligjit nr. 115/2016 dhe të pikave 5, 27 deri 37 dhe 41 të aktit nënligjor normativ, Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 2 datë 15.02.2019 “Për procedurën e shortit të caktimit të relatorëve për pozicionet vakante në çdo institucion”, si edhe të pikës 4 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, në të njëjtën ditë të mbledhjes së zhvilluar në datën 05.04.2019, është realizuar edhe procedura për caktimin me short manual të relatorëve për secilin nga vendet vakante të krijuara në Gjykatën Kushtetuese dhe për Inspektor i Lartë i Drejtësisë.

6. Sipas rezultatit të shortit manual të realizuar nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, lidhur me zgjedhjen e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, të shpallur nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi në datën 01.03.2019, relator për ndjekjen e procedurave të verifikimit, vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidaturave, është caktuar anëtarja e Këshillit, znj. Margarita Buhali.

7. Zoti Artur Metani, si njëri ndër kandidatët që ka shprehur interesin për vendin vakant të sipërcituar për Inspektor i Lartë i Drejtësisë, në zbatim të pikës 22 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi me nr. 4 datë 11.03.2019 “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, është njoftuar me shkrim për tu paraqitur pranë Këshillit për të vijuar me përmbushjen e

procedurave të verifikimit të kandidaturës. Njoftimi me shkrim, i kryer në rrugë elektronike në adresën e deklaruar nga vetë kandidati Artur Metani, gjendet e administruar në dosjen e kandidatit.

8. Në datën 08.04.2019, kandidati Artur Metani është paraqitur pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi dhe është pajisur me formularët e deklarimit dhe autorizimet që duhet të plotësohen për qëllimet e vijimit të procedurës së verifikimit të kandidaturës së tij. Kryerja e kësaj procedure vërtetohet nga nënshkrimi prej vetë kandidatit të Deklaratës përkatëse, e cila gjendet e administruar në dosjen e kandidatit.

9. Në datën 12.04.2019, kandidati Artur Metani ka depozituar në sekretarinë e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi formularë të deklarimit dhe autorizimet përkatëse për qëllimet e vijimit të procedurës së verifikimit të kandidaturës së tij, të cilat gjenden të administruara në dosjen e kandidatit.

10. Për verifikimin e kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit, lidhur me verifikimin dhe kontrollin e pasurisë, në zbatim të nenit 235 të Ligjit nr. 115/2016, si edhe në zbatim të pikës 60 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, me shkresën nr. 265 prot, datë 19.04.2019, Këshilli i ka dërguar ILDKPKI-së listën e kandidatëve dhe personave të lidhur me ta që i nënshtrohen procedurës së verifikimit të kushteve dhe kriterëve të tjera ligjore të kandidimit sipas Ligjit nr. 8577/2000 dhe Ligjit nr.115/2016.

11. Bashkëlidhur kësaj shkrese drejtuar ILDKPKI-së, ndërmjet të tjerave, është vendosur edhe Deklarata e nënshkruar nga kandidati Artur Metani, ku tregohet se është pajisur me formularët e deklarimit dhe autorizimet që duhet të plotësohen për qëllimet e procedurës së verifikimit të kandidaturës së tij, si edhe data e nënshkrimit, nga e cila fillojnë të llogariten afatet e përcaktuara nga ligji për përmbushjen e detyrimeve ligjore të kandidatit për procedurën e verifikimit të kandidaturës.

12. Me shkresën nr.2854/4 prot, datë 03.05.2019, ILDKPKI ka informuar Këshillin e Emërimeve në Drejtësi se kandidati Artur Metani e ka përmbushur detyrimin e përcaktuar nga pika 2 e nenit 235 të Ligjit nr. 115/2016 për të dorëzuar të plotësuar pranë atij institucioni Deklaratën e Pasurisë dhe Interesave Privatë të Kandidatit për Pozicione të Ndryshme në Institucionet e Sistemit të Drejtësisë.

13. ILDKPKI, në zbatim të nenit 235 të ligjit nr.115.2015, të ligjit nr. 9049/2003 dhe ligjit nr. 9367/2005, me shkresën nr. 4/28 prot., datë 28.05.2019, ka dërguar pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi rezultatet e kontrollit të ushtruar për kandidatin Artur Metani dhe personat e lidhur me të.

14. Gjithashtu, në funksion të ushtrimit të kompetencave të tij për verifikimin e plotësimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit, për sa i përket kontrollit të pasurisë, në zbatim të pikës 4 të nenit 229 dhe 235 të ligjit nr. 115/2016, të shkronjës “e” të pikës 20, 24, shkronjës “b” të pikës 60 e vijues të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, edhe ky Këshill ka kryer veprimet verifikuese të kërimit nga subjekte publike dhe private, të të dhënave mbi pasuritë, interesat private dhe detyrimet financiare që ekzistojnë në emër dhe për llogari të kandidatit Artur Metani dhe personave të lidhur me të.

15. Për realizimin e veprimeve verifikuese të lidhura me kontrollin e pasurisë së kandidatit Artur Metani, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, në datën 17.04.2019, i është drejtuar me kërkesa për institucioneve publike dhe subjekteve private (të cilat janë administruar në dosjen e kandidatit), si vijon:

- a) Institucioneve bankare: (1) Banka Alpha Albania, (2) Banka Amerikane e Investimeve, (3) Banka Credins, (4) Banka e Bashkuar e Shqipërisë, (5) Banka e Kreditit e Shqipërisë, (6) Banka e Parë e Investimeve, (7) Banka Intesa Sanpaolo, (8) Banka Kombëtare Tregtare, (9) Banka Ndërkombëtare Tregtare, (10) Banka Procredit, (11) Banka Raiffeisen, (12) Banka Societe Generale, (13) Banka Tirana dhe (14) Banka Union.
- b) Institucione financiare të licencuara nga Banka e Shqipërisë: (1) Ak-Invest, (2) Albania Leasing, (3) Capital Invest, (4) Easypay sh.p.k, (5) Final sha, (6) Fondi Besa, (7) Iutecredit Albania, (8) Landeslease, (9) M – Pay sh.p.k, (10) NOA sha, (11) Porsche Leasing, (12) Posta Shqiptare, (13) Raiffeisen Leasing, (14) Shoqëria e Parë Financiare e Zhvillimit – FAF, (15) Tirana Factoring & Lease, (16) Tranzit sha, (17) Union Financiar Tiranë.
- c) Subjekte financiare të licencuar nga AMF: (1) Fondi i Pensionit Vullnetar Credins Pension, (2) Fondi i Investimit Credins Premium, (3) Fondi i Investimit Raiffeisen Invest Euro, (4) Fondi i Investimit Raiffeisen Prestigj, (5) Fondi i Investimit Raiffeisen Vision, (6) Fondi i Investimit ËVP Top Invest, (7) Fondi i Pensionit Vullnetar Raiffeisen, (8) Fondi i Pensionit Vullnetar Sigal.
- ç) Institucione të tjera publike si: (1) Agjencia Shtetërore e Kadastrës, (2) DPSHTRR, (3) D.P.Tatimeve, (4) M.Drejtësisë, (5) OSHEE, (6) QKB, (7) UKT.

16. Në përgjigje të kërkesave për informacion të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, të gjitha institucionet publike dhe subjektet private të treguara në pikën 15 më sipër, kanë dërguar pranë Këshillit përgjigjet përkatëse ku përmbahen të gjitha të dhënat e kërkuara mbi pasuritë e kandidatëve, nëse kanë pasur të tilla për secilin prej tyre, përfshirë edhe kandidatin Artur Metani.

17. Për verifikimin e kushteve dhe kritereve ligjore të kandidimit, lidhur me verifikimin dhe kontrollin e integritetit, në zbatim të nenit 236 të Ligjit nr. 115/2016, si edhe në zbatim të pikës 82 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, me shkresën nr. 111 prot, datë 17.04.2019, Këshilli ka dërguar në Prokurorinë e Përgjithshme për kompetencë formularin e vetëdeklarimit të plotësuar sipas ligjit nr. 138/2015 nga kandidati Artur Metani.

18. Prokuroria e Përgjithshme, me shkresën nr. 1123/76 prot., datë 28.05.2019, ka dërguar pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi rezultatet e kontrollit të ushtruar për kandidatin Artur Metani.

19. Për verifikimin e kushteve dhe kritereve ligjore të kandidimit, lidhur me verifikimin dhe kontrollin e integritetit të kandidatit Artur Metani, në zbatim të nenit 236 të Ligjit nr. 115/2016, si edhe në zbatim të pikës 84 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, Këshilli i është drejtuar me kërkesë për informacion Drejtorisë së Sigurisë së Informacionit të Klasifikuar (shkresa nr. 121 prot, datë 17.04.2019), Shërbimit Informativ të Shtetit (shkresa nr. 115 prot, datë 17.04.2019), Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes (shkresa nr. 119 prot, datë

17.04.2019) dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat pranë Ministrisë së Brendshme (shkresa nr. 116 prot., datë 17.04.2019).

20. Gjithashtu, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, në vijim të procedurës së sipërcituar për verifikimin e integritetit, me shkresën nr.352 prot., datë 20.05.2019, i është drejtuar Drejtorisë së Sigurisë së Informacionit të Klasifikuar me kërkesë për ndihmë administrative për përpunimin e informacionit të klasifikuar të kërkuar pranë institucioneve përkatëse ligjzbatuese për qëllimet e verifikimit të integritetit të kandidatëve.

21. Drejtorja e Sigurisë së Informacionit të Klasifikuar dhe Shërbimi për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat pranë Ministrisë së Brendshme kanë dërguar përgjigjet e tyre, përkatësisht me shkresat nr.1545 prot., datë 10.06.2019 dhe nr. 730/1 prot., datë 20.05.2019.

22. Gjithashtu, lidhur me verifikimin dhe kontrollin e integritetit, në zbatim të nenit 229 dhe 236 të Ligjit nr. 115/2016, të dispozitave të ligjit nr. 45/2015, si edhe në zbatim të pikës 85 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, me shkresën nr. 113 prot., datë 17.04.2019, Këshilli ka dërguar formularin e aplikimit përkatës të plotësuar sipas ligjit nga kandidati Artur Metani për kompetencë dhe shqyrtim Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit.

23. Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit, me shkresën nr. 550/4 prot., datë 03.05.2019, ka dërguar pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi rezultatet e kontrollit të ushtruar për kandidatin Artur Metani.

24. Për verifikimin e kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit, në zbatim nenit 237 dhe 240 të Ligjit nr. 115/2016, si edhe në zbatim të pikave 91-93 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, Këshilli ka marrë në shqyrtim dokumentacionin përkatës të depozituar nga vetë kandidati Artur Metani në momentin e kandidimit pranë organit të emërtesës që ka shpallur vendin vakant.

25. Lidhur me kushtin e kandidimit të parashikuar nga pika 3 e nenit 147/d të Kushtetutës dhe shkronja “dh” e pikës 1 të nenit 199 të ligjit nr. 115/2016, pra që kandidati të mos ketë mbajtur pozicione drejtuese në parti politike gjatë 10 viteve të fundit nga data e kandidimit, Këshilli në datën 02.05.2019 i është drejtuar me kërkesë për informacion partive politike, si dhe Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (shkresa nr. 270 prot., datë 19.04.2019) dhe ka marrë përgjigjet përkatëse me të dhënat e kërkuara nga secili prej subjekteve private dhe institucioneve publike. Në përgjigje të këtyre kërkesave, KQZ dhe parti politike kanë dërguar informacione lidhur me ekzistencën ose jo të të dhënave që do të vërtetonin angazhimin në ndonjë pozicion drejtues në parti politike të secilit prej kandidatëve, përfshirë edhe kandidatin Artur Metani.

26. Këshilli i ka kërkuar kandidatin Artur Metani që, në zbatim të nenit 199 shkronjat “d” dhe “dh” të ligjit nr. 115/2016 “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”, të paraqesë shpjegime me shkrim dhe dokumente shtesë lidhur me ushtrimin prej tij në të kaluarën të funksionit këshilltarit pranë Presidentit të Republikës, nëse është funksion politik ose jo, për arsyen e ndërprerjes së detyrës, vërtetim nga organi kompetent që:d) nuk është pushuar nga puna më parë për shkaqe disiplinore dhe nuk ka masë disiplinore në fuqi në momentin e

kandidimit”, si edhe një deklaram që: “...dh) nuk ka mbajtur funksione politike në administratën publike ose pozicione drejtuese në parti politike gjatë 10 vjetëve të fundit përpara kandidimit”.

27. Në datën 23.04.2019, kandidati Artur Metani është përgjigjur dhe ka paraqitur me shkrim shpjegime dhe dokumente shtesë.

28. Gjithashtu, për këtë rast kandidimi, Këshilli vlerësoi ti drejtohet me kërkesa për informacion disa institucioneve publike, pranë të cilave kandidati Artur Metani ka ushtruar funksione publike apo ku gjenden të dhëna lidhur me ushtrimin e detyrave dhe veprimtarinë profesionale të kandidatit si Departamenti i Administratës Publike (shkresa nr. 274 prot, datë 19.04.2019) dhe Presidenti i Republikës (shkresa nr.273 prot, datë 19.04.2019).

29. Lidhur me të dhënat e kërkuara, Këshilli ka marrë përgjigje me shkrim nga Departamenti i Administratës Publike (shkresa nr. 2339/1 prot, datë 25.04.2019) dhe Institucioni i Presidentit të Republikës (shkresa nr. 1238/1 prot, datë 24.04.2019).

30. Në përfundim të veprimeve dhe procedurave të kontrollit dhe verifikimit, në zbatim të neneve 235, 236 dhe 237 të ligjit nr. 115/2016, si edhe të pikave 29, 75 dhe 87 të Vendimit nr. 4 datë 11.03.2019 “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, duke vlerësuar paraprakisht se ka të dhëna dhe gjetje në lidhje me ushtrimin e funksioneve politike që mund të sjellin ndalimin e kandidimit, është proceduar me përgatitjen e relacionit përkatës mbi gjendjen e faktit dhe të ligjit të zbatueshëm duke e dërguar çështjen për shqyrtim në mbledhjen e Këshillit.

31. Në zbatim të pikës 33 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, Kryetari ka thirrur mbledhjen e Këshillit duke njoftuar anëtarët për zhvillimin e saj në datën 30.07.2019, rendin e ditës, si edhe duke i bashkëlidhur njoftimit materialet e çështjes. Në rendin e ditës është përfshirë edhe çështja me objekt shqyrtimin e gjetjeve në procedurën e verifikimit të kandidimit të z. Artur Metani, për vendin vakant për Inspektor i Lartë i Drejtësisë, të shpallur nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi në datën 01.03.2019.

32. Në zbatim të pikës 34 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, dita dhe koha e zhvillimit të mbledhjes, së bashku me relacionin e përgatitur nga relatori, i është njoftuar kandidatit Artur Metani.

33. I njëjti njoftim, së bashku me dokumentacionin e përgatitur nga relatori mbi veprimet e kryera gjatë procedurës së verifikimit, si edhe materiale të çështjes, i janë dërguar edhe Avokatit të Popullit.

34. Për zhvillimin e mbledhjes së Këshillit në datën 30.07.2019, rendin e ditës dhe relacionin e përgatitur janë njoftuar edhe subjektet që sipas ligjit ftohen të marrin pjesë në mbledhjet e Këshillit.

35. Dita dhe koha e zhvillimit të mbledhjes, si edhe rendi i ditës janë njoftuar publikisht edhe në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, në pjesën e caktuar për Këshillin e Emërimeve në Drejtësi.

36. Në mbledhjen e Këshillit, pas relatimit të parashtruar nga anëtari relator dhe shpjegimeve mbi pyetjet sqaruese të drejtuara nga anëtarët e Këshillit, Këshilli dëgjoi mendimin e Avokatit të Popullit lidhur me mënyrën e procedimit të ndjekur për verifikimin e kandidatit Artur Metani.

37. Në thelb, Avokati i Popullit, krahas qëndrimit të përgjithshëm se edhe për këtë rast nuk ka pasur nga KED në dispozicion dokumentacionin e plotë, ku bashkëlidhur akteve të procedurës së verifikimit mungojnë edhe një pjesë dokumenteve dhe përgjigjeve të sjella nga institucionet, parashtror se sipas shkresës nr. 1238/1 prot, datë 24.04.2019 të Institucionit të Presidentit të Republikës *“pozicioni i punës që ka ushtruar zoti Metani si pjesë e kabinetit të Presidentit të Republikës rregullohet nga dispozitat ligjore neni 30 i ligjit 8549/1999 dhe nenet 8 dhe 14 të ligjit 8095/1996 që konsiderohet si funksionar politik”*. Në relacion rezulton se i është dërguar edhe një shkresë Departamentit të Administratës Publike por nuk është marrë ndonjë përgjigje. Ndoshta një qëndrim i këtij institucioni në lidhje me qëllimin dhe fushën e zbatimit të këtij ligji, mund të sillte më shumë elemente për Këshillin, në vlerësimin nëse jemi ose jo përpara një kushti ndalues.

38. Ligji nr. 115/2016 nuk ka specifikim se cilët këshilltarë, të cilëve kabinete të organeve shtetërore konsiderohen funksione politike, ndërkohë që në ligjin nr.84/2016 legjislatori ka parashikuar specifikisht kuptimin e shprehjes *“nuk ka ushtruar funksione politike në administratën publike”*, ku përfshihet edhe qenia *“pjesë e kabinetit të Presidentit të Republikës”*. Për sa më sipër, mendojmë se nëse ligjvënësi do të kishte pasur për qëllim të vendoste të njëjtin ndalim, do të duhet të ishte përkufizuar në të njëjtën mënyrë si në ligjin nr.84/2016. Nga ana tjetër, edhe se përcaktimi i bërë në ligjin nr.84/2016 është i ndryshëm nga ai në ligjin për nëpunësin civil (*nenet 8 dhe 14 të ligjit 8095/1996, por edhe në nenin 30 të ligjit 8549/1999*), të referuara në shkresën e sipërcituar të Institucionit të Presidentit të Republikës. Në këto dispozita, ka edhe institucione të tjera të përfshira për qëllime të atij ligji, ashtu si dhe kategori të tjera të cilat janë të përjashtuara. Prandaj mendojmë se ky kriter duhet interpretuar në përputhje me qëllimin e legjislatorit për të garantuar pavarësinë (partiake/politike) të kandidatëve për pozicionin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Në këtë kuadër, institucione të tilla si Presidenti i Republikës, Avokati i Popullit, Banka e Shqipërisë apo Kontrolli i Lartë i Shtetit, janë institucione publike jo vetëm të pavarura, por edhe të depolitizuara dhe ushtrimi i funksionit të këshilltarit në këto institucione nuk e cenon kushtin e pavarësisë nga politika. Nga ana tjetër, kandidati Artur Metani ka qëndruar në këtë pozicion gjatë mandateve të tre presidentëve radhazi (Z. Rexhep Meidani, Zoti Alfred Moisiu dhe Zoti Bamir Topi), të zgjedhur nga parlamente me shumica të ndryshme politike. Në përfundim, Avokati i Popullit është i mendimit se kjo gjetje nuk duhet të sjellë ndalimin e kandidimit, pasi në vlerësimin tonë Institucioni i Presidentit është një institucion i pavarur dhe detyra e këshilltarit ligjor të Presidentit të Republikës nuk është një funksion politik, në kuptimin e ligjit 115/1996.

II. Vlerësimi i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi

39. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, duke u bazuar në dispozitat ligjore dhe ato nënligjore normative të zbatueshme për çështjen në shqyrtim, si edhe në rrethanat e faktit që rezultojnë në aktet që përmban dosja e kandidatit, vlerëson se duhet të procedojë me vendim për lejimin

e kandidimit të kandidatit Artur Metani për vendin vakant për Inspektor i Lartë i Drejtësisë, të shpallur nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi në datën 01.03.2019.

40. Në pikën 3 të nenit 147/d të Kushtetutës, parashikohet se:

“3. Inspektori i Lartë i Drejtësisë zgjidhet me tri të pestat e të gjithë anëtarëve të Kuvendit, për një periudhë 9-vjeçare, pa të drejtë rizgjedhjeje, nga radhët e juristëve të spikatur me jo më pak se 15 vjet përvojë pune në profesion, me integritet të lartë moral dhe profesional. Ai nuk duhet të ketë mbajtur funksione politike në administratën publike, ose pozicione drejtuese në parti politike gjatë 10 vjetëve të fundit përpara kandidimit.”

41. Në pikën 1 të nenit 199 të Ligjit nr. 115/2016 parashikohet se:

“1. Inspektor i Lartë i Drejtësisë mund të zgjidhet shtetasi shqiptar, që në momentin e kandidimit përmbush këto kushte:

a) të jetë shtetas shqiptar;

b) të ketë përfunduar ciklin e dytë të studimeve universitare për drejtësi me diplomë “Master i shkencave”, ose diplomë të njësuar me të, ose studimet universitare për drejtësi jashtë shtetit dhe të ketë marrë një diplomë të njësuar, sipas rregullave për njësimin e diplomave, të parashikuara me ligj;

c) ka jo më pak se 15 vjet përvojë pune në profesion si jurist;

ç) nuk është dënuar më parë për kryerjen e një vepre penale;

d) nuk është pushuar nga puna më parë për shkaqe disiplinore dhe nuk ka masë disiplinore në fuqi në momentin e kandidimit;

dh) nuk ka mbajtur funksione politike në administratën publike ose pozicione drejtuese në parti politike gjatë 10 vjetëve të fundit përpara kandidimit;

e) nuk ka qenë anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar të ish-Sigurimit të Shtetit para 2 korrikut 1991 në kuptimin e ligjit “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”.

ë) nuk është bashkëpunëtor, informator ose agjent i shërbimeve të inteligjencës.”

42. Për sa i përket procedurës së verifikimit të pasurisë, në përfundim të veprimeve të kontrollit të ushtruar në zbatim të nenit 235 të ligjit nr.115/2015, të ligjit nr. 9049/2003 dhe ligjit nr. 9367/2005, ILDKPKI, me shkresën nr. 4/28 prot., datë 28.05.2019, ka dërguar pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi rezultatet e kontrollit të ushtruar për kandidatit Artur Metani dhe personat e lidhur me të.

43. Në përfundim të analizës së hollësishme financiare të kryer mbi bazën e gjetjeve të siguruara nga informacionet e dërguara nga institucione publike dhe subjekte private, lidhur me deklarin e pasurisë dhe interesave private të kandidatit Artur Metani, ILDKPKI në raportin e paraqitur ka ardhur në përfundimet se:

a) deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;

b) ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasurinë;

c) nuk ka kryer fshehje të pasurisë;

ç) nuk ka kryer deklarin të rremë;

d) subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

44. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi verifikoi përputhshmërinë e të dhënave të deklaruara nga kandidati Artur Metani në *Deklaratën e Pasurisë dhe Interesave Privatë të Kandidatit për Pozicione të Ndryshme në Institucionet e Sistemit të Drejtësisë* që ka depozituar pranë ILDKPKI, mbi bazën e të cilave ky institucion ka realizuar analizën financiare dhe ka ardhur në përfundimet e tij, në raport me të dhënat që rezultojnë nga informacionet e dërguara pranë Këshillit nga institucionet publike dhe private të treguara në pikën 15 të këtij Vendimi.

45. Mbi bazën e verifikimeve të kryera, Këshillit i rezulton se nuk ka gjetje që tregojnë të dhëna të padeklaruara apo mospërputhje të tyre me të dhënat e treguara në deklaratimet e bëra nga kandidati Artur Metani pranë ILDKPKI me *Deklaratën e Pasurisë dhe Interesave Privatë të Kandidatit për Pozicione të Ndryshme në Institucionet e Sistemit të Drejtësisë*.

46. Gjithashtu, Këshilli e vlerësoi të plotë dhe ezaurues, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, hetimin e thelluar dhe analizat e hollësishme financiare të realizuara nga ILDKPKI, sikurse edhe përfundimet e këtij institucioni mbi kontrollin e pasurisë dhe interesave private të kandidatit Artur Metani.

47. Për këto arsye, në zbatim të nenit 235 të ligjit nr. 115/2016, Këshilli vjen në përfundimin se kandidati Artur Metani ka *“kaluar me sukses procesin e kontrollit dhe verifikimit të pasurisë së tij personale dhe të familjarëve të tij”*. Për rrjedhojë, në zbatim të nenit 235 të ligjit nr. 115/2016, ky kandidat nuk gjendet në kushtet e ndalimit të kandidimit për sa i përket verifikimit të pasurisë.

48. Lidhur me verifikimin dhe kontrollin e integritetit, kandidati Artur Metani ka dorëzuar në afat formularin e vetëdeklarimit sipas ligjit nr. 138/2015 *“Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”*, të cilin, Këshilli ia ka përcjellë për verifikim dhe kompetencë sipas ligjit Prokurorisë së Përgjithshme.

49. Prokuroria e Përgjithshme, me shkresën nr. 1123/76 prot., datë 28.05.2019, ka dërguar pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi rezultatet e kontrollit të ushtruar, duke ardhur në përfundimet se *“Subjekti deklarues Artur Metani, kandidat për Inspektor i Lartë i Drejtësisë nuk përfshihet në fushën e veprimit të nenit 2 të ligjit nr.138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”*.

50. Prandaj, nisur nga rezultatet e kontrollit të ushtruar nga Prokuroria e Përgjithshme sipas ligjit, Këshilli vjen në përfundimin se kandidati Artur Metani, krahas plotësisht të saktë të formularit të vetëdeklarimit, përmbush kushtin e parashikuar nga shkronja “ç” e nenit 199 të ligjit nr. 115/2016, pra që kandidati *“ç) nuk është dënuar më parë për kryerjen e një vepre penale”*. Për rrjedhojë, lidhur me këtë kriter, në zbatim të nenit 236 të ligjit nr. 115/2016, ky kandidat nuk gjendet në kushtet që mund të sjellin ndalimin e kandidimit.

51. Në vijim të procedurave të verifikimit të integritetit, kandidati Artur Metani ka dorëzuar në afat formularin e aplikimit *“Për informim përpara emërimit/zgjedhjes në poste të larta”* parashikuar në ligjin nr. 45/2015, të cilin, Këshilli ia ka përcjellë për verifikim dhe kompetencë sipas ligjit Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit.

52. Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit, me shkresën nr. 550/4 prot., datë 03.05.2019, ka dërguar pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi rezultatet e kontrollit të ushtruar, duke ardhur në përfundimet se *“Për zotën Artur Muharrem Metani, nga verifikimet e kryera deri tani, nuk figurojnë të ketë materiale, në dokumente të ish-Sigurimit të Shtetit, në emër të tyre, sipas Nenit 29, pika 2 të Ligjit Nr.45/2015, “Për të Drejtën e*

Informimit për Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”.

53. Prandaj, nisur nga rezultatet e kontrollit të ushtruar nga Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit, Këshilli vjen në përfundimin se kandidati Artur Metani, krahas plotësimit të saktë të formularit përkatës të aplikimit, përmbush kushtet e parashikuara nga ligji nr. 45/2015 për pastërtinë e figurës së funksionarit kushtetues në lidhje me sjelljen dhe veprimtarinë tij përpara muajit korrik 1991. Për rrjedhojë, lidhur me këtë kriter, në zbatim të nenit 236 të ligjit nr. 115/2016, ky kandidat nuk gjendet në kushtet që mund të sjellin ndalimin e kandidimit.

54. Gjithashtu, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi verifikoi, nëpërmjet informacionit të sjellë sipas ligjit nga organe kompetente ligjzbatuese si Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, Shërbimi Informativ i Shtetit, Agjencia e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes dhe Shërbimi i Kontrollit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesave pranë Ministrisë së Brendshme, nëse kandidati Artur Metani *“ka lidhje ose kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar ose me persona të dyshuar të kimit të organizuar”*. Ky verifikim përbën standardin kushtetues dhe ligjor tashmë të vendosur për figurën dhe integritetin e funksionarëve kushtetues të sistemit të drejtësisë, përpara zgjedhjes dhe gjatë ushtrimit të funksionit, pas ndryshimeve të Kushtetutës në vitin 2016, duke pasur parasysh ato të përcaktuara edhe në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës, si edhe në ligjet e tjera të nxjerra në pajtim me të, përfshirë ligjin nr. 84/2016, pra mbi të njëjtat standarde dhe interpretim të këtij kriteri në procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve.

55. Shërbimi i Kontrollit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesave pranë Ministrisë së Brendshme me shkresën nr. 730/1 prot., datë 20.05.2019, ka përcjellë pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi informacionin e kërkuar, të cituara më sipër, nga ku rezulton se, në lidhje me kandidatin Artur Metani *“Nuk figurojnë të evidentuar për veprimtari kriminale”*.

56. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, me shkresën nr.1545 prot., datë 10.06.2019, ka përcjellë pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi informacionin e klasifikuar e të përpunuar sipas standardeve ligjore dhe profesionale për këtë kategori informacionesh, të dërguara nga agjencitë ligjzbatuese të cituara më sipër, nga ku rezulton se *“ Nuk disponohen materiale implikuese ose kompromentuese për integritetin e figurës së z. Artur Muharrem Metani”*.

57. Gjithashtu, edhe në lidhje me kushtin e kandidimit të parashikuar nga shkronja “ë” e pikës 1 të nenit 199 të ligjit nr. 115/2016, pra që kandidati *“nuk është bashkëpunëtor, informator ose agjent i shërbimeve të inteligjencës”*, në përgjigje të kërkesës për informacion të Këshillit, Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, nuk ka dërguar të dhëna të tjera të ndryshme nga ato të përcjella me shkresën nr. 1545 prot datë 10.06.2019.

58. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, bazuar në njohjen dhe shqyrtimin e informacionit të klasifikuar të dërguar nga agjencitë ligjzbatuese, vjen në përfundimin se, edhe për këto kritere, në zbatim të nenit 236 të ligjit nr. 115/2016, kandidati Artur Metani nuk gjendet në kushtet që mund të sjellin ndalimin e kandidimit.

59. Për verifikimin e kushteve dhe kriterëve të tjera ligjore të kandidimit, në zbatim të shkronjave “b”, “d” dhe “dh” të pikës 1, të nenit 199 të ligjit nr. 115/2016, të nenit 237 dhe 240 të Ligjit nr. 115/2016, si edhe në zbatim të pikave 91-93 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, Këshilli shqyrtoi dokumentacionin e depozituar nga vetë kandidati Artur Metani në momentin e kandidimit pranë organit të emërtesës që ka shpallur vendin vakant, shpjegimet dhe dokumentet shtesë të paraqitura nga kandidati mbi kërkesën e Këshillit, si edhe përgjigjet nga informacionet e kërkuara nga institucionet publike dhe subjektet private ku kandidati ka ushtruar funksione publike ose veprimtari private profesionale apo ku gjenden të dhëna lidhur me ushtrimin e detyrave dhe veprimtarinë profesionale të tij.

60. Në lidhje me kushtin e kandidimit të parashikuar nga shkronja “b” e pikës 1 të nenit 199 të ligjit nr. 115/2016, pra që kandidati të ketë *përfunduar ciklin e dytë të studimeve universitare për drejtësi me diplomë “Master i shkencave”, ose diplomë të njësuar me të, ose studimet universitare për drejtësi jashtë shtetit dhe të ketë marrë një diplomë të njësuar, sipas rregullave për njësimin e diplomave, të parashikuara me ligj*, nga dokumentacioni i shqyrtuar rezulton se kandidati Artur Metani ka përfunduar studimet dhe është diplomuar në vitin 1996 si Jurist, në Fakultetin e Drejtësisë të Universitetit të Tiranës. Në zbatim të ligjit nr. 80/2015 ky lloj arsimimi kualifikohet si arsim i lartë juridik, Diplomë e Nivelit të Dytë. Për rrjedhojë kandidati Artur Metani nuk gjendet në kushtet e ndalimit të kandidimit sipas dispozitave të sipërcituara.

61. Lidhur me kushtin e kandidimit të parashikuar nga pika 3 e nenit 147/d të Kushtetutës dhe shkronja “c” e pikës 1 të nenit 199 të ligjit nr. 115/2016, pra që kandidati të ketë *ka jo më pak se 15 vjet përvojë pune në profesion si jurist*, nga dokumentacioni i shqyrtuar, përfshirë jetëshkrimin, librezën e punës, shkresa e vërtetime të lëshuara nga organet kompetente të emërtesës etj., që janë të administruara në dosjen e kandidimit, ndërmjet të tjerave, rezulton se kandidati Artur Metani ka ushtruar veprimtari profesionale si:

- a) Stazhier, Zyrë Ligjore “Parsons, Behle & Latimer” Dhjetor 1997 - Maj 1998;
- b) Stazhier, Komiteti Organizator i Lojërave Olimpikë Dimërore 2012, Nëntor 1997 - Maj 1998;
- c) Koordinatori Programit të Drejtësisë, Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë (OSFA), Shkurt 1999 - Maj 2002;
- ç) Asistent Pedagog/Lektor në Disiplinën e së Drejtës Kushtetuese, Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Tiranës, 1998-2008;
- d) Anëtar i Bordit Drejtues / Anëtar i Asamblesë së Përgjithshme të Komitetit Shqiptar Të Helsinkit 2001 -2016 ;
- dh) Ekspert Ligjor PAMECA Janar 2005 - Shtator 2006 ;
- e) Anëtar i Këshillit të Avokaturës Së Shtetit 2005 - 2006 ;
- ë) Anëtar i Këshillit të Prokurorisë Prokuroria e Përgjithshme 2005 - 2008 ;
- f) Ekspert Ligjor, Euralius, Maj - Dhjetor 2011 ;
- g) Ekspert Ligjor, Instituti për Studime Publike dhe Ligjore, Dhjetor 2011-Prill 2012 ;
- gj) Konsulent Ligjor, Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë (OSFA) Gusht - Dhjetor 2012;
- h) Asistent Pedagog/ Lektor në Disiplinën e së Drejtës Kushtetuese, Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Tiranës, 2012 – 2013;
- i) Konsulent Ligjor, Delegacioni i Bashkimit Evropian Në Shqipëri 2011 – 2013;
- j) Këshilltar Juridik, Institucioni i Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Maj 2002 - Korrik 2012 ;

- k) Drejtor i Përgjithshëm, Departamenti i Legjislacionit Monitorimit të Programeve Dhe Antikorrupsionit (Anëtar i Trupës së Nivelit të Lartë Drejtues), Kryeministria, 1 Nëntor 2013 - 24 Nëntor 2017
- l) Drejtor i Përgjithshëm, Departamenti Rregullator dhe i Përputhshmërisë (Anëtar i Trupës së Nivelit të Lartë Drejtues), Kryeministria 24 Nëntor 2017-21-Tetor 2018;
- m) Avokati Përgjithshëm i Shtetit Avokatura E Shtetit 22 Tetor 2018 – Aktualisht.

62. Bazuar në gjetjet e cituara më sipër, Këshilli konstaton se kandidati Artur Metani ka ushtruar së paku për 15 vjet veprimtari profesionale nga ato të parashikuara si kusht për lejimin e kandidimit nga pika 3 e nenit 147/d të Kushtetutës dhe shkronja “c” e pikës 1 të nenit 199 të ligjit nr. 115/2016.

63. Për sa i përket kushtit të kandidimit të parashikuar nga pika 3 e nenit 147/d të Kushtetutës dhe shkronja “dh” e pikës 1 të nenit 199 të ligjit nr. 115/2016, pra që kandidati *nuk ka mbajtur funksione politike në administratën publike ...*, sikurse parashtrohet më sipër, si edhe nga jetëshkrimi dhe aktet e administruara në dosjen e kandidimit për veprimtaritë e tjera të ushtruara, Këshilli konstaton se, kandidati Artur Metani ka ushtruar funksionin e këshilltarit juridik të Presidentit të Republikës.

64. Në përgjigje të shkresës së Këshillit me nr.273 prot, datë 19.04.2019, Institucioni i Presidentit të Republikës, nëpërmjet shkresës nr. 1238/1 prot, datë 24.04.2019, parashtron se: *pozicioni i punës që ka ushtruar zoti Metani si pjesë e kabinetit të Presidentit të Republikës rregullohet nga dispozitat ligjore neni 30 i ligjit 8549/1999 dhe nenet 8 dhe 14 të ligjit 8095/1996 që konsiderohet si funksionar politik.*

65. Në zbatim të pikës 1, shkronja “dh” të nenit 199 të ligjit nr. 115/2016, në datën 19.04.2019 nga ana e Këshillit i janë kërkuar shpjegime kandidatit Artur Metani lidhur me natyrën dhe statusin e tij në ushtrimin e funksionit të këshilltarit të Presidentit të Republikës, si edhe dokumentacion mbështetës të nevojshëm sipas vlerësimit të tij.

66. Kandidati Artur Metani, në datën 23.04.2019, ka depozituar pranë Këshillit shpjegimet e tij me shkrim lidhur me gjetjet e njoftuara të procedurës së verifikimit për sa i përket ushtrimit ose jo të funksioneve politike. Në thelb, në shpjegimet e tij, kandidati Artur Metani, parashtron se nuk bën pjesë në rrethin e subjekteve të ndaluara për kandidim për shkak të nenit 199, pika 1, shkronja “dh”, të ligjit nr. 115/2016, bazuar në arsyetimin kushtetues, ligjor dhe logjik si më poshtë:

- a) Eksperienca profesionale si këshilltar në Kabinetin e Presidentit të Republikës nuk mund të konsiderohet si funksion politik, në kuptim të nenit 147/d, pika 3, të Kushtetutës dhe nenit 199, pika 1, shkronja “dh”, të ligjit nr. 115/2016.
- b) Presidenti i Republikës i ushtron kompetencat e tij, kryesisht në këto drejtime: (i) mbikëqyrjen e veprimtarisë shtetërore (si kryetar i shtetit); (ii) përfaqësimin e shtetit jashtë vendit; si dhe (iii) integritetin shtetëror. Presidenti nuk qeveris dhe nuk administron, ai qëndron mbi të gjitha pushtetet dhe nuk bën pjesë në to. Ai konsiderohet si një organ *sui generis* dhe ushtron funksionet e parashikuara në Kushtetutën e Republikën e Shqipërisë në mënyrë të pavarur. Kushtetuta ndalon shprehimisht mundësinë e ushtrimit të aktivitetit politik nga ana e Presidentit, pasi bërja e politikës, pra qeverisja, i është lënë në dorë Kuvendit dhe Qeverisë. Presidenti i Republikës ka rolin e kryetarit të shtetit, si dhe për sa njihet nga regjimet e republikave parlamentare, sikurse është Republika e Shqipërisë, pra është një president joqeverisës.

- c) Sipas Komisionit të Venecias në shumicën e regjimeve parlamentare, Kreu i Shtetit luan rolin e arbitrit ose “*pouvoir neutre*”, i shkëputur nga politika partiake. Funksionet kryesore të Kryetarit të Shtetit, në kuadër të këtij modeli, janë të përfaqësojë shtetin në marrëdhëniet me jashtë, të marrë pjesë në emërimin e disa zyrtarëve kyç shtetërorë, të garantojë funksionimin e institucioneve shtetërore, por jo të përcaktojë drejtimin aktual politik të vendit, pasi ky rol i takon Parlamentit dhe ekzekutivit. Presidenti është një element i rëndësishëm i sistemit politik, por nuk është partiak. Kompetencat e Presidentit në një regjim parlamentar përcaktohen nga pozita neutrale e Presidentit. Në këtë kuadër, paraprakisht vlerësohet se Presidenti i Republikës nuk mund të jetë aktiv ose zotërues në procese vendimmarrëse politike. Një gjë e tillë përforcohet më shumë, duke konsideruar faktin që Kushtetuta e ndalon Presidentin të jetë anëtar partie me qëllim shmangien e çdo qendrimi politiko- partiak në ushtrimin e funksioneve të tij shtetërore.
- ç) Presidenti i Republikës, për shkak të natyrës institucionale që i ka dhënë Kushtetuta, nuk zgjidhet apo emërohet politikisht. Pra, Presidenti nuk i nënshtrohet një votimi popullor për zgjedhjen e tij, duke mos marrë një mandat politik për ushtrimin e kompetencave të tij.
- d) Presidenti i Republikës, gjithashtu, nuk emërohet politikisht, por zgjidhet nga Kuvendi, sipas procedurës përkatëse, duke u propozuar nga një grup deputetësh, jo detyrimisht, të një force politike apo koalicioni politik, duke u zgjedhur me votë, si edhe drejtues të tjerë të institucioneve të tjera të pavarura, si psh, Avokati i Popullit, Guvernatori i Bankës, Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, etj.
- dh) Në vijim të këtij arsytimi, paraprakisht vlerësohet se përderisa nga ana e institucionit të Presidentit të Republikës nuk ushtrohen funksione të karakterit politik, atëherë edhe anëtarët e kabinetit të Presidentit nuk mund të konsiderohen funksionarë politikë. Struktura e kabinetit mbështet drejtpërdrejtë Presidentin e Republikës në realizimin e kompetencave të tij. Funksionarët e kabinetit të Presidentit të Republikës nuk ushtrojnë asnjë kompetencë drejtuese apo politike, pasi Kabineti është strukturë organizative ndihmëse që funksionon pranë Presidentit dhe shërben si organ këshillimor pranë tij. Kabineti varet drejtpërsëdrejti nga Presidenti dhe nuk është pjesë përbërëse e pushtetit legjislativ, pushtetit ekzekutiv apo atij gjyqësor. Anëtarët e kabinetit të Presidentit të Republikës janë të detyruar të demonstrojnë, nëpërmjet ushtrimit të detyrave të tyre, luajalitet personal, si dhe përkushtim profesional në raport me kompetencat e Presidentit të Republikës, i cili, në vetvete, nuk ka kompetenca politike. Për pasojë, edhe funksioni i këshilltarit mbështetet në funksionet që Kushtetuta i përcakton Presidentit të Republikës dhe pozicionit të tij si përfaqësues i unitetit kombëtar, përfaqësues i shtetit dhe autoriteti më i lartë i tij, me funksion të veshur me prestigj dhe që qëndron mbi palët dhe që i ndalohet me Kushtetutë çdo veprimtari politike apo të pozicionuar politikisht.
- e) Në këto kushte, nuk mund të hiqet paralele ndërmjet kabineteve dhe këshilltarëve të institucioneve që ushtrojnë funksione politike dhe institucioneve që u ndalohet shprehimisht të ushtrojnë funksione politike. Vetëm përdorimi i termit të njëjtë, që përdoret për efekt të kategorizimit të pozicionit të punës, nuk e bën funksionin të barasvlerëshëm.
- ë) Në këto kushte, anëtarët e kabinetit të Presidentit të Republikës dallojnë nga “këshilltarët politik”, jo vetëm duke mbajtur në konsideratë rolin e Presidentit në Republikën e Shqipërisë, si dhe kompetencat të cilat mund të ushtrohen nga ana e tij, por edhe dallimin që ai ka me një këshilltar politik (në përbërje të kabinetit të funksionarit qeverisës), i cili duhet të ketë përafërsi të forta politike me programin politik të partive mazhoritare qeverisëse. Kjo do të thotë që këshilltari politik duhet të akordojë mjaftueshëm me programin politik të qeverisë për të siguruar se këshilla që jep përputhet me vlerat dhe pikëpamjet e përgjithshme politike të programit qeverisës. Në të njëjtën kohë, vlen të theksohet se përzgjedhja e anëtarëve të kabinetit të Presidentit të Republikës nuk

udhëhiqet nga pikëpamje të karakterit politik, por këta anëtarë rekrutohen për shkak të njohurive apo eksperiencës së tyre në një fushë të caktuar, si dhe zakonisht kanë një kualifikim të caktuar profesional apo specializim akademik.

- f) Në mbështetje të arsyetimit të mësipërm dhe në analizë të Kushtetutës dhe ligjeve të dala në zbatim të reformës në drejtësi, konstatohet lehtësisht se i gjithë ky korpus ligjor është hartuar mbi një projekt, saktësisht, të përcaktuar dhe të harmonizuar. Ligjet e dala në zbatim të Kushtetutës, janë projektuar, konceptuar dhe hartuar nga i njëjti mendim juridik, bazuar në të njëjtin vizion dhe miratuar në të njëjtën kohë, si paketë e zbrërthimit të konceptit kushtetues të reformës në drejtësi. Këto ligje, duke marrë në konsideratë, ndër të tjera, edhe konceptet e analizës së parashtruar më sipër, duke e ditur qartësisht faktin se Presidenti i Republikës nuk është funksionar politik, për pasojë as këshilltarët e tij, kanë bërë përcaktime të ndryshme për situata të ndryshme ligjore. Kështu, po t'i referohemi ligjit 84/2016, ai ka përjashtuar në mënyrë të shprehur tek ndalesat për ushtrimin e pozicionit, një kategori subjektësh, ndër ta edhe këshilltarin e Presidentit të Republikës. Nga ana tjetër, kjo nuk e bën automatikisht këshilltarin e Presidentit apo qoftë edhe Presidentin njeri politik, por në kuptim të këtij ligji, ligjvënësi, ka dashur të përjashtojë në mënyrë të shprehur këshilltarin e Presidentit nga ushtrimi i funksioneve të anëtarit të institucioneve të rivlerësimit, ashtu sikurse ka përjashtuar, për arsye të vlerësimit politik si më sipër, edhe ekspertët e nivelit të lartë që hartuan reformën në drejtësi. Të njëjtin qëndrim ka mbajtur ligjvënësi edhe në rastin e ligjit 96/2016, në nenin 2 germa "c", duke e shprehur vullnetin e tij për përjashtimin e "këshilltarit të Presidentit të Republikës", nga ushtrimi i funksionit edhe sipas këtij ligji. Por, ky vlerësim i ligjvënësit nuk u shtri në aktet e tjera ligjore që përbëjnë korpusin e ligjeve të reformës në drejtësi, duke bërë qartazi dallimin e vullnetit të ligjvënësit për të gjitha rastet e tjera dhe duke e bërë të qartë, kështu se, qëndrimi i mbajtur në ligjin 84/2016, nuk është rastësor dhe se Kuvendi, kur e ka vlerësuar, është shprehur në mënyrë të drejtpërdrejtë. Në ligjin 115/2016, nuk gjendet togfjalëshi "këshilltari i Presidentit", por përdoret termi i përgjithshëm "funksionar politik në administratën publike", që nuk i korrespondon funksioneve dhe pozicionit të këshilltarit të Presidentit. Po ky vullnet i ligjvënësit, nuk ndalon ekspertët e nivelit të lartë të kandidojnë për funksione të larta të drejtësisë dhe të organeve të tjera. Në të njëjtën kohë, në të njëjtin korpus ligjesh, nga të njëjtët hartues, nga i njëjti Kuvend, mbështetur në të njëjtin korpus ndryshimesh të ligjit themeltar, është mbajtur qëndrim diferencues, duke treguar dukshëm vullnetin e ligjvënësit. Nëse legjislatori do të donte t'i jepte të njëjtin kuptim funksionit politik në ligjin 115/2016, edhe në bazë të rregullave të teknikës legislative, do të kishte përkufizuar shprehjen ose do të referonte në mënyrë të shprehur te kuptimi që i ka dhënë kësaj shprehjeje në ligjin 84/2016 apo 96/2016.
- g) Ushtrimin e funksionit si këshilltar juridik i Presidentit të Republikës e kam filluar në Maj 2002, gjatë kohës kur President i Republikës ishte z. Rexhep Meidani. Më pas, kam vijuar të punoj edhe me President Alfred Moisiu (2002 - 2007) dhe President Bamir Topi (2007 -2012). Gjatë kësaj periudhe kam gëzuar vlerësimin e të tre Presidenteve dhe nuk kam marrë asnjë vërejtje apo masë disiplinore. Madje, President Alfred Moisiu më ka akorduar Medaljen "Për merita të veçanta civile", me motivacionin "Për ndihmesë të veçantë në realizimin me nivel të lartë të detyrave të ngarkuara nga Institucioni i Presidentit të Republikës", nr. dekreti 5427, datë 23.7.2007. Në korrik 2012, me ardhjen e Presidentit Bujar Nishani, për shkak të qëndrimit të gjatë në detyrë dhe të një vlerësimi të dyanshëm, të Presidentit dhe timit, unë jam liruar nga detyra në korrik 2012.

67. Këshilli vëren se Kushtetuta, në nenin 147/d, pika 3, parashikon se Inspektori i Lartë i Drejtësisë“ *nuk duhet të ketë mbajtur funksione politike në administratën publike, ose pozicione drejtuese në parti politike gjatë 10 vjetëve të fundit përpara kandidimit*”. Në zbatim dhe pajtim me këtë normë kushtetuese, edhe në nenin 199, pika 1, shkronja “dh” të ligjit 115/2016, si një nga kushtet ndaluese për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë, parashikohet që të mos ketë mbajtur *“funksione politike në administratën publike ose ... gjatë 10 vjetëve të fundit përpara kandidimit”*.

68. Këshilli thekson se në dispozitat kushtetuese, ashtu edhe në ligjin nr.115/2016, (për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë), që rregullon organizimin dhe funksionimin e ILD, nuk është dhënë ndonjë përkufizim i termit "funksion politik", apo të jetë përcaktuar rrethi i subjekteve që kryejnë funksione politike.

69. Këshilli vlerëson të theksojë së koncepti kushtetues dhe ligjor "funksionar politik", nuk është detajuar dhe specifikuar për kandidatët për ILD, sikundër ligjvënësi ka vepruar në ligje të tjera të posaçme, ku ky koncept është detajuar dhe specifikuar për qëllimet e këtyre ligjeve¹. Për këtë arsye, Këshilli, si organ kushtetues kompetent për verifikimin e kandidaturave për ILD, vlerëson se duhet t'i përgjigjet pyetjes: Kufizimi i vendosur nga Kushtetuta dhe ligji nr.115/2016, a kanë pasur si qëllim përjashtimin nga kandidimi të këshilltarit të Presidentit dhe për rrjedhojë a duhet të konsiderohet "funksionar politik" në administratë publike, pozicioni i këshilltarit juridik të Presidentit?

70. Në lidhje me sa më lart, në funksion të analizës mbi pozicionin *“këshilltar juridik i Presidentit”*, Këshilli vlerëson t'i referohet Kushtetutës dhe jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese lidhur me rolin dhe funksionet e Presidentit të Republikës, dhe përmes metodës së interpretimit teleologjik, të konkludojë mbi pozicionin e këshilltarit pranë Presidentit si funksion politik ose jo, për sa vijon.

71. Kushtetuta parashikon se: "Sipas nenit 86/1 të Kushtetutës, Presidenti i Republikës është Kryetar i Shtetit dhe përfaqëson unitetin e popullit". Sipas jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese, theksohet se: "Kompetencat e Presidentit, bazuar në teknikën legjislativë të ndjekur nga hartuesit e Kushtetutës, nuk janë të renditura njëra pas tjetrës, por janë të shpërndara nëpër krerë të ndryshëm të Kushtetutës. *Hartuesit e Kushtetutës e konceptuan rolin e tij si atë të arbitrit, të moderatorit të pushteteve e të rregullatorit, si një figurë neutrale, me një rol të rëndësishëm në zgjidhjen e krizave, në balancimin e pushteteve, si dhe në kryerjen e funksioneve të tyre respektive*. Nga ekspertët kushtetues u vlerësua, gjithashtu,

¹Mund të përmendim për sa vijon: Ligji nr.84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve", Neni 3:17. Shprehja "nuk ka ushtruar funksione politike në administratën publike" do të thotë që nuk ka qenë deputet, Kryeministër, Zëvendës-krye-ministër, ministër, zëvendësministër ose nëpunës pjesë e kabinetit të Presidentit të Republikës, Kryetarit të Kuvendit, Kryeministrit, Zëvendës-kryeministrit, ose ministrit që kryen detyrën e drejtorit të kabinetit, këshilltarit, ndihmësit, zëdhënësit ose sekretarit personal të titullarit të kabinetit; - Ligji per nr.152/2013 "Për Nëpunësin Civil", neni 4: ç) "Funksionar i kabinetit" është nëpunësi, pjesë e kabinetit të Presidentit, Kryetarit të Kuvendit, Kryeministrit, Zëvendëskryeministrit, ministrit, apo pjesë e kabinetit të një titullari të një institucioni të pavarur apo një funksionari të emëruar nga Kuvendi ose Presidenti, nëse parashikohet nga ligji, që kryen detyra të drejtorit të kabinetit, këshilltarit, ndihmësit, zëdhënësit apo sekretarit personal të titullarit të kabinetit; - Ligji 90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore" Neni 17: 1. Kabineti i ministrit mund të ketë një drejtor, këshilltarët dhe sekretarët. Ata emërohen dhe shkarkohen nga ministri dhe kanë statusin e funksionarëve politikë, sipas ligjit.2. Rregullat për organizimin dhe funksionimin e kabineteve miratohen nga Këshilli i Ministrave. Struktura dhe organika e kabinetit miratohen si pjesë e organizimit të brendshëm të ministrisë.

edhe nevoja për ta përshtatur institucionin e Presidentit me regjimin parlamentar dhe vendosjen e një qeverie më të përgjegjshme dhe më të fortë në themel të tij. Në aspektin e përgjithshëm, Gjykata, për sa i përket pozicionit kushtetues të Presidentit, ka theksuar se kompetencat e tij janë përcaktuar në zbatim të parimit të shtetit të së drejtës. Parimi i shtetit të së drejtës, i sanksionuar në nenin 4 të Kushtetutës, nënkupton veprimin e të gjitha institucioneve shtetërore sipas së drejtës në fuqi, si dhe supremacinë e Kushtetutës ndaj akteve të tjera normative. Çdo organ në një shtet të së drejtës duhet të veprojë për aq sa i lejon Kushtetuta dhe ligji, duke mos i tejkaluar kufijtë e përcaktuar prej tyre. Në këtë kuptim, çdo institucion shtetëror duhet të ketë të përcaktuar qartë fushën e kompetencave të veta brenda të cilave është i autorizuar të veprojë në përputhje me kërkesat kushtetuese dhe ligjore. Sipas neneve 89, 90/1 dhe 94 të Kushtetutës, Presidenti nuk mund të mbajë asnjë detyrë tjetër publike, nuk mund të jetë anëtar partie dhe as të kryejë veprimtari tjetër private; nuk ka përgjegjësi për aktet e kryera në ushtrim të detyrës së tij dhe nuk mund të ushtrojë kompetenca të tjera përveç atyre që i njihen shprehimisht me Kushtetutë dhe që i jepen me ligje të nxjerra në pajtim me të”. (vendimi nr.10 datë 26.02.2015, prg.9-10).

72. Gjithashtu, kjo Gjykatë ka theksuar se, nga përmbajtja dhe fryma e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, del se veprimtaria e Presidentit të Republikës si kryetar shteti, ka elementë të tre pushteteve; legjislativ, ekzekutiv e gjyqësor. (vendimi nr.25, datë 13.02.2002)

73. Këshilli vlerëson të theksojë se edhe Komisioni i Venecias, është shprehur se në shumicën e regjimeve parlamentare, Kreu i Shtetit luan rolin e arbitrit ose “*pouvoir neutre*” (pushteti neutral), i shkëputur nga politika partiake².

74. Duke pasur në konsideratë sa më lart, Këshilli vlerëson se përderisa nga ana e institucionit të Presidentit të Republikës nuk ushtrohen funksione të karakterit politik/partiak, atëherë edhe anëtarët e kabinetit të Presidentit nuk mund të konsiderohen funksionarë politikë. Struktura e kabinetit mbështet drejtpërdrejtë Presidentin e Republikës në realizimin e kompetencave të tij. Kabineti është strukturë organizative ndihmëse që funksionon pranë Presidentit dhe shërben si organ këshillimor pranë tij. Për pasojë, edhe funksioni i këshilltarit mbështetet në funksionet që Kushtetuta i përcakton Presidentit të Republikës dhe pozicionit të tij si përfaqësues i unitetit kombëtar, përfaqësues i shtetit, me funksion që qëndron mbi palët dhe që i ndalohet me Kushtetutë çdo veprimtari politike apo të pozicionuar politikisht. Në vijim të këtij arsytimi, Këshilli thekson se kompetencat kushtetuese dhe roli i Presidentit në Republikën Parlamentare, janë të tilla që punësimi pranë këtij Institucioni, nuk mund të konsiderohen të natyrës politike/partiake.

75. Për më tepër, Këshilli vlerëson të sjellë dhe argumente shtesë, lidhur me teknikën legjislativë të përdorur nga ligjvënësi për ligjet e miratuara në kuadër të Reformës në Drejtësi, ku përfshihet dhe ligji nr.115/2016. Kështu, nëse ligjvënësi do kishte pasur qëllim që të ndalonte si pozicion edhe këshilltarin e Presidentit për kandidatin për ILD, atëherë do të përdorte të njëjtën teknikë legjislativë, për të dhënë të njëjtin përkufizim në ligjin nr.115/2016 lidhur me Inspektorin e Lartë të Drejtësisë, sikundër ka bërë me ligjin nr.84/2016, në nenin 3/17, ku ia ka ndaluar kandidimin Këshilltarit të Presidentit për institucionet e rivlerësimit kalimtar³, si legjislation i përgatitur, diskutuar dhe miratuar në të

² Opinioni nr. 886/2017 I Komisionit të venecias, CDL-AD (2017)014, Republic of Moldova, “Opinion on the proposal by the President of the Republic to expand the President’s powers to dissolve Parliament”, Strasbourg, 19.06.2017, paragrafi nr. 20.

³Neni 3 i ligjit:“17. Shprehja “nuk ka ushtruar funksione politike në administratën publike” do të thotë që nuk ka qenë deputet, Kryeministër, Zëvendëskryeministër, ministër, zëvendësministër ose nëpunës pjesë e kabinetit të Presidentit të

njëjtën kohë, mbi të njëjtat rrethana, gjetje dhe synime nga ana e ligjvënësit. Për rrjedhojë, Këshilli vlerëson se për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë nuk mund të kërkohet të bëhet referimi në ndonjë kusht pengues që parashikojnë ligje të tjera, por vetëm në kushtet dhe kriteret e përcaktuara në ligjin e posaçëm që rregullon veprimtarinë e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

76. Për sa më lart, Këshilli konkludon se funksionari i këshilltarit juridik pranë Presidentit, nuk mund të konsiderohet funksion politik në administratë publike, në kuptim të ligjit nr. 115/2016.

77. Përveç sa më lart, në funksion të kësaj vendimmarrje, Këshilli konsideron të rëndësishëm edhe argumentin e sjellë nga vetë kandidati, i së cilës ka asistuar juridikisht institucionin e Presidentit, me drejtësi të Republikës, të zgjedhur në periudha kohore të ndryshme parlamentare.

78. Si përfundim, Këshilli vlerëson se, përderisa kufizime të tilla nuk parashikohen në ligjin 115/2016, atëherë kandidati Artur Metani nuk gjendet në kushtet e ndalimit të kandidimit sipas kushtit të përcaktuar në shkronjën "dh" të pikës 1 të nenit 199 dhe nenit 237 të ligjit 115/2016.

79. Lidhur me kushtin e kandidimit të parashikuar nga pika 3 e nenit 147/d të Kushtetutës dhe shkronja "dh" e pikës 1 të nenit 199 të ligjit nr. 115/2016, pra që kandidati të mos ketë mbajtur pozicione drejtuese në parti politike gjatë 10 viteve të fundit përpara kandidimit, nga shqyrtimi i jetëshkrimit dhe të dhënave që rezultojnë nga aktet e administruara në dosjen e kandidimit, sikurse janë korrespondencat me partitë politike, Këshilli konstaton se kandidati Artur Metani nuk ka mbajtur pozicione drejtuese në parti politike (gjatë 10 viteve të fundit nga data e kandidimit). Për rrjedhojë kandidati Artur Metani nuk gjendet në kushtet e ndalimit të kandidimit sipas dispozitave të sipërcituara.

80. Në shkronjën "d" të pikës 1 të nenit 199 të ligjit nr. 115/2016, si kusht kandidimi përcaktohet që kandidati nuk është pushuar nga puna më parë për shkaqe disiplinore dhe nuk ka masë disiplinore në fuqi në momentin e kandidimit. Nga dokumentacioni i shqyrtuar, përfshirë jetëshkrimin, librezën e punës, shkresa e vërtetime të lëshuara nga organet kompetente të emërtesës etj., që janë të administruara në dosjen e kandidimit, Këshilli konstaton se kandidati Artur Metani nuk rezulton të jetë larguar nga detyra për shkaqe disiplinore. Përkështu, nuk rezulton që kandidati të ketë masë disiplinore në fuqi. Për rrjedhojë kandidati Artur Metani nuk gjendet në kushtet e ndalimit të kandidimit sipas kësaj dispozite.

81. Nisur nga sa analizohet dhe arsyeohet më sipër, bazuar më gjetjet dhe të dhënat e konstatuara gjatë procedurës së verifikimit që rezultojnë nga aktet dhe dokumentacioni që përmban dosja e kandidimit, në interpretim dhe zbatim të ligjit të zbatueshëm për kushtet dhe kriteret e kandidimit për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi vjen në përfundim se duhet të vendoset lejimi i kandidimit të kandidati Artur Metani në vendin vakant për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë, të shpallur nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi në datën 01.03.2019.

PËR KËTO ARSYE:

Në mbështetje të pikës 1 të nenit 149/d të Kushtetutës, të pikës 3 të nenit 229 dhe pikës 4 të nenit 235, pikës 5 të nenit 236, pikës 3 të nenit 237 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, si edhe të shkronjës “a” të pikës 50 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi

VENDOSI:

1. Lejimin e kandidimit të kandidatit Artur Metani, në vendim vakant për Inspektor i Lartë i Drejtësisë, të shpallur nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi në datën 01.03.2019.
2. Në zbatim të nenit 238 të Ligjit nr. 115/2016, ky vendim i njoftohet kandidatit Artur Metani.
3. Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, në pjesën e përcaktuar për Këshillin e Emërimeve në Drejtësi.



MENDIM PAKICE

Ne anëtarët **Margarita Buhali** dhe **Arta Marku** kemi votuar kundër vendimit të marrë nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi me nr.100 dt.30.07.2019 për lejimin e kandidimit të z.Artur Metani në postin e Inspektorit të lartë të Drejtësisë.

Për mendimin tonë z.Artur Metani nuk plotëson kushtet ligjore të kandidimit sipas nenit 237 dhe 199/1/dh të ligjit nr.115/2016 dhe **për këtë shkak duhet të vendosej ndalimi i kandidimit**. Në zbatim të nenit 47 të vendimit nr.4/2019 të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi paraqesin mendimin në pakicë kundër vendimit nr.100 dt.30.07.2019 për sa mëposhtë:

1-Sipas shkresës së datës 24.04.2019 pozicioni i punës së A.Metani është konsideruar nga Presidenca, ku ai ka ushtruar detyrën si “**funksionar politik**”. Në referim të kësaj shkrese rezulton se emërimi i tij në punë është bërë në bazë të nenit 30 të ligjit nr.8549/1999 dhe neneve 8 dhe 14 të ligjit nr.8095/1996. Gjithashtu nga librezja e punës rezulton se kandidati ka mbajtur detyrën e këshilltarit të presidentit deri në vitin 2012, periudhë kjo që përfshihet brenda afatit 10 vjeçar, kur ndalohet kandidimi për Inspektor të Lartë të Drejtësisë nga funksionarët politikë sipas nenit 199/1/dh të ligjit nr.115/2016.

Duke pasur në konsideratë këto referenca të dhëna për mënyrën si është emëruar në detyrë kandidati rezulton se në momentin e emërimit të tij në detyrë janë marrë në konsideratë ligji nr.8549/1999 dhe ai nr.8095/1996. Ligji nr.152 dt.30.05.2013 “Për shërbimin civil” që shfuqizoi ligjin nr.8449/1999 është miratuar dhe ka hyrë në fuqi pasi kandidati ka ndërprerë marrëdhënien e punës si këshilltar i presidentit.

Nga dispozitat ligjore në fuqi në kohën e emërimit deri të ndërprerjes së marrëdhënies së punës së kandidatit në pozicionin e këshilltarit të presidentit, pra për periudhën 2002-2012 veçohen si më poshtë:

Neni 1 i ligjit nr.8549/1999 ka përcaktuar: Qëllimi i këtij ligji është përcaktimi i rregullave të njëjta për kushtet dhe procedurat e pranimit në shërbimin civil, për mënyrën e fillimit dhe mbarimit të marrëdhënieve të punës, për zhvillimin e karrierës, për garantimin e të drejtave dhe përcaktimin e detyrimeve të nëpunësve civilë, me synim krijimin e një shërbimi civil të qëndrueshëm, profesional dhe eficient.

Neni 2 përkufizime: "Institucionet e administratës publike të nivelit qendror apo vendor" në kuptim të këtij ligji janë: Administrata e Kuvendit, **Administrata e Presidentit**, Aparati i Këshillit të Ministrave, ministrinë, institucionet qendrore të pavarura , bashkitë dhe qarqet.

Neni 30 i ligjit nr.8549/1999 ka parashikuar se: Ligji nr. 8095, datë 21.03.1996 "Për Shërbimin Civil në Republikën e Shqipërisë", **përveç dispozitave për funksionarin politik**, shfuqizohet. Të gjitha dispozitat e tjera, që bien në kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohen.

Ndërsa në ligjin nr.8095 dt.21.03.1996 përfshihen këto dispozita;

Neni 2 Shërbimi civil

Në shërbimin civil të Republikës së Shqipërisë bëjnë pjesë: **1. Funkionarët politikë, pozita juridike e të cilëve përcaktohet me ligje të veçanta dhe me dispozitat e kreut të dytë të këtij ligji.**

Neni 8;

Emërimi dhe lirimi nga detyra në shërbimin civil bëhet nga organi ose institucioni që në bazë të ligjit e gëzon këtë të drejtë. Emërimi i bërë nga një organ a institucion, i cili nuk e gëzon këtë të drejtë, është i pavlefshëm. Emërimi është i pavlefshëm edhe kur: 1. Personi i emëruar nuk plotëson kushtin për shtetësinë, në bazë të paragrafit 2 të nenit 6, dhe nuk është bërë përjashtim në bazë të paragrafit 3 të nenit 6. 2. Personi i emëruar nuk ka zotësi për të vepruar. 3. Në bazë të ligjit, personi i emëruar nuk gëzon të drejtën për të punuar në administratën publike. Marrëdhënia juridike e shërbimit civil fillon në momentin e emërimit dhe zgjat deri në lirim nga detyra ose derisa të zgjasë afati ligjor i ushtrimit të veprimtarisë. Marrëdhënia juridike e shërbimit civil merr fund gjithashtu: a) Kur personi vdes. b) Kur personi del në pension. c) Kur personi është dënuar me vendim të gjykatës të formës së prerë për kryerjen e një krimi. d) Kur personi jep dorëheqjen. dh) Për një nga arsyet e përmendura në pikat 1, 2 dhe 3 të paragrafit të mësipërm. e) Kur personi është i paafte për të kryer detyrat në shërbimin civil.

Neni 13

Funksionarët politikë

Funksionarët politikë, për të cilët zbatohen dispozitat e këtij ligji, janë të gjithë personat që ushtrojnë funksione drejtuese politike në organet qendrore dhe lokale të administratës publike, titullarë dhe zëvendës të tyre në institucionet publike të specializuara, **si dhe personat që ushtrojnë veprimtari të drejtpërdrejtë ndihmëse për realizimin e funksioneve politike të personave të lartpërmendur.**

Marrëdhëniet juridike të deputetëve të Kuvendit Popullor, Presidentit të Republikës, e të personave të zgjedhur në organet e pushtetit lokal rregullohen me dispozita juridike të veçanta.

Neni 14- Marrëdhënia juridike e funksionarëve politikë

Marrëdhënia juridike e funksionarëve politikë fillon me zgjedhjen ose emërimin e tyre, sipas kushteve dhe kërkesave të përcaktuara në dispozitat juridike përkatëse.

Në rast se në ligjet përkatëse nuk përcaktohet ndryshe, marrëdhënia juridike e funksionarëve politikë merr fund për një nga shkaqet e përmendura në paragrafin 3 të nenit 8, **si dhe për motive politike.**

Neni 15 I ndryshuar me ligjin nr. 8300 dt.02.03.1999 parashikon se

Postet e strukturës organizative të shërbimit civil që do të zihen nga funksionarë politikë, paraqiten sipas shtojcës 1 të bashkëlidhur."

SHTOJCA NR.1

Lista e funksionarëve politikë që janë objekt i ligjit "Për shërbimin civil në Republikën e Shqipërisë", si edhe institucionet përkatëse janë si më poshtë:

I. NË PRESIDENCE

1. Sekretari i Përgjithshëm.

2. Anëtarë të kabinetit të Presidentit të Republikës dhe anëtarët e kabinetit të sekretarit të Përgjithshëm të Presidencës, ku hyjnë: Shefi i kabinetit, këshilltarët, ndihmësit, zëdhënësit pranë kabineteve dhe sekretarët personalë.

3. Këshilltarët e Presidentit jashtë kabinetit.

Duke mbajtur në konsideratë të gjithë kuadrin ligjor në fuqi në kohën e emërimit në detyrën e këshilltarit të Presidentit të kandidatit Artur Metani rezultoi se pozicioni i punës i mbajtur prej tij konsiderohet si funksionar politik. Kjo evidentohet me mënyrën e caktimit në këtë detyrë të funksionarëve politik e cila ndryshon nga ajo e nëpunësve civil, pasi emërohen në mënyrë të drejtëpërdrejtë nga titullari i institucionit pa konkurim dhe kryejnë veprimtari të drejtëpërdrejtë ndihmëse për realizimin e funksioneve politike të personave, që ushtron funksionin drejtues politik. Sipas shtojcës 1 të sipërcituar të shtuar me ligjin nr.8300/1999 rezultoi se konsiderohen funksionar politik anëtarët e kabinetit të presidentit të Republikës, ku përfshihen edhe këshilltarët. Si rrjedhim në përputhje me ligjin në fuqi nga momenti i emërimit deri në largimin e kandidatit nga pozicioni i këshilltarit të presidentit, ky pozicion punë konsiderohet si funksionar politik. Ligji nr.152/2013 "Për shërbimin civil në Republikën e Shqipërisë" nuk bëri asnjë përcaktim të ndryshëm për pozicionin e këshilltarit të presidentit, duke përjashtuar nga fusha e zbatimit të tij sipas nenit 2/c funksionarët e emëruar nga Kuvendi, Presidenti i Republikës ose Këshilli i Ministrave.

Nga sa mësipër rezultoi se posti i këshilltarit të presidentit i mbajtur nga kandidati A.Metani për periudhën nga vitet 2002 deri në vitin 2012 konsiderohet funksion politik.

2- Çështja e dytë që lind për diskutim është nëse këshilltari i presidentit konsiderohet apo jo funksion politik në administratën publike, i përcaktuar si kusht ndalues për kandidim në postin e inspektorit të lartë të Drejtësisë sipas nenit 147/d/3 të Kushtetutës dhe nenit 199/1/dh të ligjit nr.115/2016?

Nga shpjegimet e dhëna personalisht nga vetë kandidati rezultoi se ai nuk e konsideron eksperiencën e tij në punë në kabinetin e presidentit si funksion politik bazuar në nenin 147/d pika 3 të Kushtetutës dhe nenin 199/1/dh të ligjit nr.115/2016. Në thelb të pretendimit veç interpretimit ligjor të nenit 2 të ligjit nr.96/2016 dhe ligjit nr.84/2016 kandidati ka shpjeguar se presidenti nuk ushtron funksione të karakterit politik dhe si rrjedhim edhe pjesëtarët e kabinetit të tij nuk mund të konsiderohen politikë. Gjithashtu sipas kandidatit termi funksionar politik në administratën publike nuk përfshin këshilltarët e presidentit.

Lidhur me kuadrin ligjor që ndalon kandidimin për inspektor të lartë të drejtësisë të personave, që kanë mbajtur funksione politike në administratën politike gjatë 10 viteve të fundit para kandidimit parashikimet janë;

a-Neni 147/d/3 i Kushtetutës (funksione politike në administratën publike)

b-Neni 199 e ligjit nr.115/2016 (funksione politike në administratën publike)

Kuptimi i shprehjes nuk ka ushtruar funksione politike në administratën publike është përkufizuar në pikën 17 të ligjit nr.84/2016 ku thuhet se; Shprehja "nuk ka ushtruar funksione politike në administratën publike" do të thotë që nuk ka qenë deputet, Kryeministër, Zëvendëskryeministër, ministër, zëvendësministër ose **nëpunës pjesë e kabinetit të Presidentit të Republikës**, Kryetarit të Kuvendit, Kryeministrit, Zëvendëskryeministrit, ose

ministrit që kryen detyrën e drejtorit të kabinetit, **këshilltarit**, ndihmësit, zëdhënësit ose sekretarit personal të titullarit të kabinetit.

Të njëjtin përkufizim gjejmë edhe në ligjin nr.96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, ku në nenin 2 pika c parashikohet se : ç) "Nuk ka ushtruar funksione politike në administratën publike" do të thotë që nuk ka qenë deputet, Kryeministër, Zëvendëskrye-ministër, ministër, zëvendësministër ose **nëpunës, pjesë e kabinetit të Presidentit të Republikës**, Kryetarit të Kuvendit, Kryeministrit, Zëvendëskryeministrit ose ministrit, **që kryen detyrën e drejtorit të kabinetit, këshilltarit, ndihmësit, zëdhënësit ose sekretarit personal të titullarit të kabinetit**.

Sipas këtyre dispozitave është përcaktuar kuptimi i togfjalëshit "funksione politike në administratën publike" si në drejtim të konceptit administratë publike dhe funksionit politike. Kështu administratë publike është konsideruar ndër të tjera edhe kabineti i Presidentit të Republikës krahas kabinetit të kryetarit të Kuvendit, kryeministrit, ministrit etj. ndërsa "funksioni politike" i referohet detyrës konkrete, ku përfshihen: detyra e drejtorit të kabinetit, këshilltarit, ndihmësit, sekretarit personal të titullarit të kabinetit. Duke mbajtur në konsideratë këto përcaktime kandidati Artur Metani konsiderohet se ka ushtruar funksione politike në administratën publike gjatë afatit 10 vjecar nga kandidimi pasi ka mbajtur detyrën e këshilltarit, pjesë e kabinetit të Presidentit të Republikës deri në vitin 2012.

Ne anëtarët në pakicë të KED vlerësojnë se në rastin konkret kuptimi i kushtit ndalues "funksione politike në administratën publike" i përdorur në nenin 147/d të Kushtetutës dhe në nenin 199/1/dh të ligjit nr.115/2016 është i njëjtë me kuptimin e të njëjtit togfjalësh të përcaktuar në dispozitat e përkufizimeve në ligjin nr.84/2016 dhe 96/2016. Të dy këto ligje gjejnë zbatim për të përcaktuar kuptimin e këtij togfjalëshi edhe në ligjin nr.115/2016. Në arritjen e këtij konkluzioni ne anëtarët e KED në pakicë mbajmë në konsideratë sa më poshtë:

a-Ky togfjalësh është përdorur si kusht ndalues jo vetëm për emërimin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë në nenin 147/d, por edhe në një sërë dispozitash të tjera, që kanë të bëjnë me kandidat për organet e tjera kushtetuese më konkretisht:

- i- Në nenin 125/3 të Kushtetutës, që parashikon rregulla për emërimin e gjyqtarëve të gjykatës kushtetuese.
- ii- Në nenin 136 të Kushtetutës për emërimin si gjyqtar të gjykatës së lartë nga rradhën e juristëve.
- iii- Në nenin 147/3 të Kushtetutës për anëtarët e këshillit të lartë gjyqsor që përzgjidhen nga rradhët e juristëve.
- iv- Në nenin 148/a/4 të Kushtetutës për kandidimin për prokuror të përgjithshëm.
- v- Në nenin 149/3 të Kushtetutës për kandidatët joprokuror në Këshillin e lartë të Prokurorisë
- vi- Në nenin C pika 6 të Shtojcës së Kushtetutës për kandidatët e komisionit të pavarur të kualifikimit dhe gjyqtarët e kolegjit të apelimit.

Nga këto dispozita rezulton se Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë ka zgjedhur të përjashtojë nga kandidimi personat, që kanë mbajtur funksione politike në administratën publike gjatë 10 viteve të fundit para kandidimit, në të gjitha organet e sistemit të drejtësisë, organet e vettingut dhe gjykatën Kushtetuese. Kjo është bërë me një qëllim të lartë kushtetues për të shmangur çdo lloj perceptimi për ndikim të drejtpërdrejtë ose indirekt të politikës mbi sistemin e drejtësisë dhe për të rritur besueshmërinë në pavarësinë e paanëshmërinë e sistemit gjyqsor. Duke qenë se i njëjti kusht ndalues është përdorur si për kandidatët e organeve të vettingut, për kandidatët për gjykatën e lartë e prokuror të përgjithshëm ose anëtarët e KLGJ e KLP jogjyqtar, ashtu dhe për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë, atëherë është e qartë se ky

kusht ndalues ka të njëjtin kuptim në çdo rast të kandidimit në pozicionet e cituara në dispozitat e mësipërme të kushtetutës. Vetëm në këtë situatë ky kusht ndalues do të përmbushte qëllimin për të cilin ishte parashikuar në Kushtetutë. Çdo interpretim i ndryshëm, që mund t'i bëhej këtij kushti në varësi të pozicionit, për të cilën konkurohej do të shkaktonte diferencim të zbatimit të tij megjithëse kuptimi, që i ishte dhënë nga ligji më i lartë themelor i shtetit ishte i njëjtë. Lidhur me organet kushtetuese, funksionimi i të cilave në mënyrë të detajuar rregullohej me ligje të vecanta ndiqet parimi i interpretimit të njëjtë të koncepteve për të siguruar zbatimin unik të dispozitave kushtetuese.

b-Mungesa e përkufizimit të togfjalëshit “funksione politike në administratën publike” në ligjin nr.115/2016 nuk do të thotë se ligjvënësi ka pasur si qëllim t'i jap një kuptim të ndryshëm këtij togfjalëshi në këtë ligj nga ligjet e tjera nr.84/2016 dhe 96/2016 pjesë e paketës së reformës në drejtësi. Ligjvënësi në ligjin nr.115/2016 nuk ka dhënë përkufizimin e asnjë togfjalëshi ose koncepti, të përfshirë në përmbajtjen e tij, gjë që është bërë qëllimisht pasi përkufizimet e termave të përdorura në këtë ligj ishin dhënë në mënyrë të detajuar në ligjet e tjera pjesë e paketës së reformës në drejtësi, të cilat ishin miratuar në kohë më parë se ligji nr.115/2016. Duke qenë se në këto ligje ishin rregulluar mënyra e organizimit të institucioneve të tjera kushtetuese të sistemit të drejtësisë dhe të realizimit të procesit të vettingut, ato në mënyrë pararendëse kishin sqaruar kuptimin e togfjalëshit “funksione politike në administratë politike”, gjë që bënte të panevojshme ripërsëritjen e përkufizimit të këtij togfjalëshi edhe në ligjin nr.115/2016.

Gjithashtu neni 204 i ligjit nr.115/2016 parashikon zbatimin e ligjit nr.96/2016 për kualifikimet e inspektorëve dhe të stafit administrativ të Inspektoriatit duke detyruar Inspektorin e Lartë të Drejtësisë, që të përcaktojë kriteret për kualifikimet e tyre *në përputhje me këtë ligj, ligjin "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" dhe ligjin "Për nëpunësin civil"*. Mbi këtë përcaktim rezulton se referimi te ligji nr.96/2016 nuk mbetet vetëm në kuadër të interpretimit harmonik të ligjeve, por një detyrim ligjor i parashikuar nga vete ligji nr.115/2016. Për atë kohë sa kërkohet zbatimin e kriterëve kualifikues të ligjit nr.96/2016, atëherë normalisht që interpretimi i këtyre kriterëve do të bëhet sipas përkufizimeve të tij.

c-Arsyetimi se presidenti është një organ kushtetues, që nuk ushtron funksione politike dhe përfaqëson unitetin e popullit, nuk mund të përbëjë shkak për të përjashtuar zbatimin e nenit 147/d të Kushtetutës dhe nenit 199/1/dh të 115/2016 për funksionarët, që kanë mbajtur funksione politike në kabinetin e presidentit, ku përfshihet edhe kandidati Artur Metani si këshilltar i presidentit. Në këtë rast ligjvënësi ka dhënë në mënyrë të shprehur në disa dispozita ligjore kuptimin e togfjalëshit “funksione publike në administratën publike”, ku ka përfshirë edhe punonjësit e kabinetit të presidentit duke i cituar në mënyrë të detajuar pozicionet e punës, që gëzojnë cilësinë e funksionarëve politik midis të cilëve është dhe këshilltari i presidentit. Këto parashikime ligjore nuk lënë hapësirë për interpretim të ndryshëm të togfjalëshit “funksione publike në administratën publike” për kategorinë e nëpunësve, që kanë qenë pjesë e stafit të kabinetit të presidentit sipas përcaktimeve të përkufizimeve të ligjit nr.84/2016 dhe 96/2016. Ligjvënësi ka pasur si qëllim të shmangë përfshirjen në organet e sistemit të drejtësisë të të gjithë funksionarëve politikë, pavarësisht nga organi, pranë të cilit ata kishin realizuar këtë funksion qoftë ky edhe Presidenti. Në kushtet, kur kandidati ka mbajtur funksione politike në administratën publike deri në vitin 2012, pasi ishte emëruar dhe kishte ushtruar detyrën si funksionar politik, ai automatikisht është i përjashtuar nga kandidimi për Inspektor të lartë të Drejtësisë sipas nenit 199/1/dh i ligjit nr.115/2016.

Për sa mësipër

Bazuar në nenet 199/1/dh dhe 237 të ligjit nr.115/2016

Mendimi ynë në pakicë lidhur me kandidimin e z. Artur Metani është;

-Ndalimin e kandidimit të z.Artur Metani në vendin vakand të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

ANËTARE

Arta MARKU



ANËTARE/RELATORE

Margarita BUHALI



[shqiptarja.com]